



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	19.03.2025 <u>01-11210-13391</u>
Për:	Shefqet Shehu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale në pjesët e ngastrave P-70705029-03404-1, P-70705029-05833-1 dhe P-70705029-03406-0

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 17 pika 6 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, me qëllim të formimit të komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, Kryetari i Komunës së Gjakovës me datë 19.03.2026 e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

### PROPOZIM VENDIM

1. Kuvendi i Komunës të formojë Komisionin Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale – parkingu, në pjesët e ngastrave P-70705029-03404-1, P-70705029-05833-1 dhe P-70705029-03406-0 Z.K Gjakovë – Qytet.
2. Kryetari i Komunës propozon dy (2) anëtarë nga ekzekutivi i komunës, Kuvendi i Komunës propozon dy (2) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga radhët e subjekteve politike dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar.
3. Ky komision vlerësues ka mandat për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale sipas pikës 1 të këtij propozim vendimi.

Me respekt!